



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 42 Prot

Tiranë, më 14.10. 2011

VENDIM Nr. 6 dt. 06.10.2011

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 06.10.2011, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës, sipas pikave të rendit të ditës:

VENDOSI:

I. Lidhur me projektet e shqyrtuara në mbledhjen e KKR, dt. 15.07.2011 dhe të rishqyrtuara në mbledhjen e KKR dt. 06.10.2011:

1. **Rimiratohet:** Propozim për vënie në mbrojtje "Pazari i Bilishtit"
2. **Rimiratohet:** Propozim për krijimin e një Qendre historike, në qytetin e Pogradecit, dhe rregullorja përkatëse.
3. **Rimiratohet:** Projekti i rikonstruksionit dhe shtesë banese 2 dhe 3 kate me podrum me investitor Fatos Ceta, Korçë.
4. **Rimiratohet:** Projekti i rikonstruksionit dhe shtesë banese 2 dhe 3 kate me podrum me investitor Sotiraq Ceta, Korçë.
5. **Rimiratohet me shumicë votash:** Projekt për rivitalizim dhe konservim të zonës historike Kalaja e Ndroqit, Tiranë.
 - **Ndërhyrjet nën tokë (gërmimet arkeologjike) të jenë nën supervizimin e arkeologjisë.**
6. **Miratohet** Shtesë papafingo mbi objektin e Albtelekom 3-KT, Berat.
 - **Lejohet ndërtimi provizor deri në përfundimin e kontratës së albtelekom me subjektin qiramarrës.**
7. **Rimiratohet me shumicë votash:** Projekt ndërtim Godinë banimi dhe shërbimesh 1 KT, 4 KT, 5 KT, me 1 KT nën tokë mbulesa çati, lagja 10 Korriku, zona tampon Berat, me pronar G. Kajana, L. Hoxha, F. Çobo, **me kondicionin:**
 - **Të reduktohet sipërfaqja e xhamit në fasadën e objektit.**

8. **Rimiratohet:** Projekt riformulimi urbanistiko-arkitektonik i objektit 3 kate me Bodrum, Zona e Mbrojtur Shkodër. Pronar Mark dhe Pëllumb Ndou.

9. **Rimiratohet:** Detyrë projektimi për studimin urbanistik në zonën “Kalaja e Turrës”. (miratuar nga KKA me Vendim nr 121, dt. 07.12.2010).

- **Ndërhyrjet në zonën me potencial arkeologjik të jenë nën supërvizimin e ASHA-s.**

10. **Rimiratohet me shumicë votash** “Projekt për rivitalizimin e dy kullave dhe portës lindore të Via Egnatia, Elbasan”.

11. **Miratohet:** Projekt restaurimi i banesës individuale 2 katëshe, me pronar Rajmonda dhe Gjergji Trebicka, lagja 3, rruga Jeronim De Rada, nr. 7, Korçë.

12. **Rimiratohet:** Paketa e projekteve të restaurimit të ikonave:

- “Krishti Pantokrator”, shek XVIII, autori anonim.
- “Dyert e Bukura”, autor Onufer Qiprioti, shek XVI.
- “Hyrja e Shën Mërisë në tempull”, autor David Selenica, shek XVIII.
- “Shën Pjetri e Pavli”, autor Konstantin Jeromonaku, shek XVIII.
- “Shpërfytyrimi”, autor David Selenica, shek XVIII.

13. Ngarkohet IMK, të përgatisë dhe të sjellë për shqyrtim në KKR, teknologjinë e ndërhyrjeve në ikona, mbi të cilën do të bazohet hartimi i projekteve të konsolidimit dhe restaurimit të ikonave.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

ALDO BUMÇI

SEKRETAR I KKR
AKADEMIK. APOLLON BAÇE